

Vendim Nr. _____

Datë 08.03.2021

VENDIM I ASAMBLESË
SË ORTAKËVE TË SHOQËRISË
"JALA INVESTMENT" SHPK

Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë **"JALA INVESTMENT" SHPK** me nr. NIPT M02215013N, e thirrur nga Administratori i saj **z. Saimir Boka**, zhvilloi mbledhjen e saj sot më datë 08.03.2021, ora 16.00, me rendin e ditës si vijon:

- **Zmadhimi i kapitalit të shoqërisë.**
- **Ndryshimi i statutit të shoqërisë.**

Ortakët e shoqërisë të pranishëm në mbledhje janë:


- 1. Shoqëria "ANDI." SHPK**, zotëruese e kuotës që përfaqëson 70 % të kapitalit të shoqërisë, përfaqësuar nga administratori **z. Andi Gjikhuri**;
- 2. Shoqëria "AIG" SHPK**, zotëruese e kuotës që përfaqëson 30 % të kapitalit të shoqërisë, përfaqësuar nga administratori **z. Jonian Antoni**.

Pasi u mor në shqyrtim çështja e rendit të ditës, u konstatua se janë respektuar dispozitat përkatëse ligjore dhe dispozitat e statutit të shoqërisë lidhur me procedurën e thirrjes së mbledhjes së asamblesë dhe pjesëmarrjen e ortakëve, dhe se kjo çështje e rendit të ditës bën pjesë në kompetencat e Asamblesë së shoqërisë, sikurse është përcaktuar në Statutin e shoqërisë si dhe në dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar.

Ortakët e shoqërisë bien dakord dhe pranojnë se:

- Zmadhimi i kapitalit të shoqërisë do kryhet nëpërmjet kontributit në para dhe konkretisht nëpërmjet vlerës prej EUR 1,032,000 (një milion e tridhjetë e dy mijë Euro), që do të derdhet nga ortaku shoqëria "AIG" SHPK në llogarinë e shoqërisë "Jala Investment" SHPK.
- Shoqëria "AIG" SHPK nëpërmjet këtij kontributi do të bëhet ortakë e pjesës/kuotës që përfaqëson 40 % të kapitalit të shoqërisë, ndërsa shoqëria "ANDI." SHPK do të bëhet zotëruese e kuotës/pjesës që përfaqëson 60 % të kapitalit të shoqërisë.¹

¹ Në përputhje me germen L të Nenit 1 dhe pikën 5.7 të Nenit 5 të Marrëveshjes së Ortakëve datë 03.03.2021, regjistruar me aplikimin me nr. CN-667979-03-21 në QKB.



- Pavarësisht se depozitimi i vlerës së mësipërme në llogarinë e shoqërisë "Jala Investment" SHPK nuk do të bëhet në mënyrë të menjëhershme, zmadhimi i kapitalit të shoqërisë do të regjistrohet në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Për sa më sipër, në përfundim të diskutimeve, Asambleja e Ortakëve të shoqërisë "JALA INVESTMENT" SHPK, unanimisht,

VENDOSI:

1. Të miratojë zmadhimin e kapitalit të shoqërisë, duke i shtuar vlerën prej EUR² 1,032,000 (një milion e tridhjetë e dy mijë Euro), vlerë e cila do të transferohet nga ortaku shoqëria "AIG" SHPK në llogarinë e shoqërisë "Jala Investment" SHPK. Në referencë të pikës 5.7 të marrëveshjes së ortakëve të datës 03.03.2021 (depozituar dhe miratuar nga QKB), ky kontribut i AIG SHPK do të njihet si kontribut edhe në favor të shoqërisë "ANDI." SHPK.
2. Kapitali i ri i shoqërisë Jala Investment SHPK do të jetë në vlerën totale prej ALL 258,077,409 (dyqind e pesëdhjetë e tetë milion e shtatëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e nëntë Lekë), i ndarë sipas tabelës si më poshtë:

ORTAKËT	NUMRI I KUOTAVE/ PJESËVE	VLERA E KAPITALIT NË "ALL"		PËRQINDJA E PRONËSISË
		Para	Natyrë	
SHOQËRIA "ANDI." SHPK	1	76,396,996	91,524,374.30	60 %
SHOQËRIA "AIG" SHPK	1	50,931,264	39,224,774.70	40 %

3. Ndryshimin e Statutit të shoqërisë duke miratuar draftin e ri bashkëlidhur këtij vendimi.

² Sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë të datës 08.03.2021 (1 Euro = 123.38 Lek), në vlerën prej ALL 127,328,160 (njëqind e njëzet e shtatë milion e treqind e njëzet e tetë mijë e njëqind e gjashtë dhjetë Lekë)

ORTAKËT E SHOQËRISË "JALA INVESTMENT" SHPK

SHOQËRIA "ANDI." SHPK

Përfaqësuar nga:

Z. Andi Gjikhuri



[emër, mbiemër, firmë, vulë]



SHOQËRIA "AIG" SHPK

Përfaqësuar nga:

Z. Jonian Antoni


[emër, mbiemër, firmë, vulë]

